REPUBLIKA E KOSOVËS

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 21.17.1-2015-08

RAPORTI I AUDITIMIT

PËR PASQYRAT FINANCIARE TË MINISTRISË PËR FORCËN E SIGURISË SË KOSOVËS PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2015

Prishtinë, qershor 2016

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për t'u kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne po rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe po luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinioni i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit Valbon Bytyqi, i mbështetur nga, Udhëheqësi i ekipit Shkëlqim Xhema dhe Anëtarja e ekipit Leonora Hasani.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme....4

1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm....6

2 Qeverisja....9

3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli....14

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit....21

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP....22

Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak....25


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës për vitin 2015 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderojmë Ministrin dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2015 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorit Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 26/11/2015.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën I):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2015 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinioni

Shtojca II shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm është:


<u>Opinion i pamodifikuar</u>

Pasqyrat financiare *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Formulimi i plotë i fjalëve është dhënë në hollësi në Pjesën 1.2 të këtij raporti.

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:



Përgjigja e Ministrit – auditimi 2015

Ministri ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet e dhëna.

1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

1.1 Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF-ve) të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuara në PVF. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur PVF-të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata për prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PVF-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.2 Opinioni i Auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Ne kemi audituar PVF-të e MFSK-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale, shënimet shpjeguese të PVF-ve si dhe shpalosjet.

Sipas mendimit tonë PVF-të prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale të pranimeve dhe pagesave, si dhe të buxhetit të realizuar të MFSK-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullën financiare të MF, nr. 03/2013 për PVF-të e organizatave buxhetore.

Baza për Opinionin

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa, Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e PVF-ve. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të PVF-ve të organizatave Buxhetore në Kosovë, ZAP është i pavarur nga MFSK dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe personave përgjegjës për Qeverisje dhe PVF-të

Sekretari i Përgjithshëm i MFSK-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të PVF-ve sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrolle të brendshme të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e PVF-ve pa keqdeklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PVF-ve

Përgjegjësia jonë është që ta shprehim një opinion për PVF-të në bazë të auditimit tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike, ta planifikojmë dhe ta kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për atë nëse PVF-të nuk kanë keqdeklarime materiale.

Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse PVF-të në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë gjithnjë një keqdeklarim material kur ajo ekziston. Keqdeklarimet mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritet që të ndikojnë vendimet e përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre PVF-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe shpalosjeve në PVF. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në PVF, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori e konsideron kontrollin e brendshëm që është relevant në PVF nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të PVF-ve.

1.3 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera për raportim

MFSK kërkohet të veproj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Kërkesat e Rregullores nr. 01/2013/MF - Shpenzimi i parave publike;
- Kërkesat e Rregullores MF-nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare të organizatave buxhetore;
- Kërkesat nga Rregulla financiare nr.02/2013/MF për raportimin e obligimeve të papaguara të organizatave buxhetore; dhe
- Kërkesat e procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Në kontekst të PVF-ve, ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto. Çështjet e ngritura në Memon tonë të auditimit të ndërmjetëm, të datës 26/11/2015, dhe çështje të ngritura në fazën finale në lidhje me kornizën raportuese janë adresuar nga Menaxhmenti.

Marrë parasysh çka u tha më lart, Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF me rastin e dorëzimit të draft PVF-ve në Ministrinë e Financave (MF) mund të konsiderohet e plotë dhe e saktë në të gjitha aspektet materiale.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur. Ato janë përmbushur në tërësi nga MFSK.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime lidhur me PVF-të.

2 Qeverisja

2.1 Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për MFSK-në që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vetvlerësimit që plotësohet nga të gjitha organizatat buxhetore siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një organizatë individuale buxhetore të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse. Prandaj, ne e kemi aplikuar një qasje konsistente në të gjitha auditimet për ta përcaktuar cilësinë e listave kontrolluese të plotësuara për vetvlerësim dhe për ta vlerësuar saktësinë e gjendjes së paraqitur mbi qeverisjen në Kosovë.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes e pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku ne besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuara përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij raporti).

2.2 Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Qeverisja në MFSK në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial pasqyron një situatë pozitive. MFSK ka implementuar pjesën më të madhe të rekomandimeve si dhe ka hartuar një listë të detajuar të vetvlerësimit për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Gjithashtu ka përgatitur raportin e menaxhimit të rrezikut duke identifikuar të gjitha rreziqet domethënëse që mund të kenë ndikim tek organizata në lidhje me arritjen e objektivave të saj.

Cilësia e raportimit të brendshëm funksionon sipas zinxhirit llogaridhënës dhe atij komandues, mbahen takime të rregullta, duke raportuar dhe diskutuar për të gjitha aktivitetet. Njëherit, menaxhmenti ka nxjerr vendim për të implementuar të gjitha çështjet që dalin nga auditimet për të forcuar kontrollin e brendshëm.

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) kishte realizuar disa raporte të auditimit për menaxhmentin. Ato ofronin një pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë së kontrolleve të brendshme dhe efektivitetin e tyre.

2.3 Rekomandimet e vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e MFSK-së për vitin 2014 ka rezultuar me 10 rekomandime kryesore. MFSK kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të implementohen të gjitha rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2015, shtatë rekomandime janë implementuar, një është adresuar dhe dy nuk janë implementuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

Çështja 1 – Implementimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

E gjetura

Pavarësisht përgatitjes së planit të veprimit lidhur me adresimin e rekomandimeve si dhe angazhimit të MFSK-së për të adresuar këto çështje, dy rekomandime kanë mbetur ende të pa adresuara.

Rekomandimet e pa adresuara ndërlidhën me: Planifikimin dhe realizimin e buxhetit për projektet kapitale dhe të planit të rrjedhës së parasë si dhe lidhur me menaxhimin e personelit.

Menaxhmenti së bashku me personat përgjegjës, ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të adresuar rekomandimet e mbetura.

Rreziku

Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve të tjera në sisteme kyçe financiare dhe të cilat nuk janë adresuar, kanë rezultuar në:

- Dobësi të vazhdueshme në ekzekutimin e buxhetit; dhe
- Kontrolle jo të mjaftueshme në aktivitetet e menaxhimit të personelit.

Rekomandimi 1

Ministri duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për implementimin e rekomandimeve të bëra nga AP-ja, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.

2.4 Lista kontrolluese e vetvlerësimit të MFK-së

MF ka hartuar një listë të detajuar të vetvlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vetvlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar nga një pyetje kyçe në secilën komponentë të listës kontrolluese.

Ne kemi përmbledhur konkluzionet tona për MFSK-në të cilat se bashku me të gjeturat dhe konkluzionet e nxjerra në auditimet tjera do të konsolidohet në Raportin tonë Vjetor të Auditimit. Kjo nuk ka për qëllim të jap koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vetvlerësimit por do ta jap gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për t'i mbështetur përpjekjet e MF-së në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar gjashtë pyetje kyçe të pyetësorit të vetvlerësimit në lidhje me pesë komponentë. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se:

- Komponenti 1 "Ambienti i kontrollit", menaxherët e njësive kanë qenë të përfshirë në diskutimet për planin e strategjisë, përfshirë edhe këshilltarë ndërkombëtar. Ndërsa lidhur me koston e strategjisë ajo ishte në përputhje apo e mbështetur nga Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (2014-2016);
- Komponenti 2 "Menaxhimi i rrezikut", gjatë procesit të planifikimit të rrezikut janë marrë parasysh burime të jashtme dhe të brendshme. Në regjistrin e rreziqeve janë dhënë përgjigjeje nga secila njësi duke raportuar tek koordinatori i procesit të menaxhimit të rrezikut;
- Komponenti 3 "Aktivitetet e kontrollit", plani i prokurimit përgatitet në përputhje me disponueshmërinë e fondeve buxhetore të miratuara. Pas miratimit të buxhetit, MFSK e përgatitë planin final të prokurimit dhe të njëjtin e dërgon në Autoritetin Qendror të Prokurimit;
- Komponenti 4 "Informimi dhe komunikimi", lidhur me raportimin në kohën e duhur për vendimmarrje, përgatiten raporte mujore dhe, sipas nevojave, edhe javore e ditore; dhe
- Komponenti 5 "Aktivitetet e monitorimit", arritja e objektivave dhe analizimi i shkaqeve për dështimet e mundshme monitorohen në mënyrë të rregullt nga menaxherët e njësive në kuadër të MFSK-së. Ndërsa monitorimin, vlerësimin dhe analizimin e bën Departamenti për politika dhe plane në periudha tremujore dhe vjetore.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.5 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar në planifikimin e auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit MFSK operon dhe sfidat me të cilat përballet.

2.5.1 Vlerësimi i rrezikut

Të gjitha organizatat buxhetore pritet të zbatojnë vlerësimin e rrezikut. Udhëzimet e përcaktuara kërkojnë që regjistri i rrezikut të jetë i kompletuar për të mbështetur menaxhimin efektiv, operacional dhe strategjik.

MFSK ka hartuar regjistrin e rreziqeve duke i identifikuar të gjitha rreziqet domethënëse që mund të kenë ndikim tek organizata në lidhje me arritjen e objektivave të saj.

Si kërkesë e menaxhimit financiar dhe kontrollit, MFSK ka emëruar Koordinatorin e Procesit të Menaxhimit të Rrezikut. Po ashtu, kishte hartuar regjistrin me rreziqet e identifikuara ku ishte vlerësuar mundësia e ndodhjes dhe ndikimi i tyre i mundshëm përfshirë edhe trajtimin dhe monitorimin e tyre. Gjithashtu ishte bërë analiza dhe raporti përfundimtar mbi sistemin e menaxhimit vjetor të rreziqeve.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.5.2 Raportimi Menaxherial

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Menaxhmenti i MFSK-së kishte dizajnuar një sistem të mirë të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar.

Procesi i raportimit të brendshëm në MFSK funksionon sipas zinxhirit llogaridhënës dhe atij komandues të parashikuar me ligjin dhe strukturën organizative të MFSK-së dhe FSK-së. Lidhur me këtë, menaxhmenti mban takime të rregullta me të gjitha departamentet dhe njësitë e saj. Temat dhe konkluzionet e takimeve ishin pasqyruar në procesverbalet e rregullta.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) operon me tre anëtarë të stafit - Drejtori i NJAB-së dhe dy auditorë. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës, i cili reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të MFSK-së dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja nga një Komitet efektiv auditimi.

NJAB ka hartuar planin strategjik dhe vjetor ku janë paraparë tetë auditime gjatë vitit 2015, duke u fokusuar në fushat të cilat paraqesin rrezik të lartë. Kjo njësi ka përmbushur në tërësi planifikimin duke dhënë rekomandime konkrete për përmirësimin dhe funksionimin e kontrolleve të brendshme.

Në këto raporte, NJAB kishte dhënë 33 rekomandime lidhur me përmirësimin e funksionimit të kontrollit të brendshëm. Prej tyre 10 janë adresuar plotësisht, 17 janë në proces të adresimit dhe gjashtë nuk janë adresuar.

Komiteti i auditimit (KA), kishte mbajtur katër takime të rregullta dhe kishte shqyrtuar gjetjet dhe rekomandimet e NJAB-së si dhe mënyrën e adresimit të rekomandimeve.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

3.1 Hyrje

Puna jonë për MFK-në jashtë fushave të Qeverisjes të përmendura në kapitullin dy pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve. Si pjesë e kësaj ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

3.2 Konkluzioni për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

MFSK në përgjithësi ka kontrolle të mira në raport me obligimet statutore të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli ka dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit. Përjashtim nga kjo bëjnë disa çështje në aspektin e pajtueshmërisë lidhur me zbatimin e rregulloreve të prokurimit dhe të rregullave të shërbimit civil.

Në vitin 2015, MFSK kishte një realizim të mirë të buxhetit, megjithëse, buxheti për investime kapitale nuk është shpenzuar në pajtueshmëri më planin e rrjedhjes së parasë. Afro 69% e buxhetit ishte shpenzuar në tremujorin e fundit.

Te pasuria dhe obligimet nuk kemi vërejtur ndonjë parregullsi në menaxhimin dhe raportimin e tyre.

3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për MFSK-në, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike si dhe të hyrat e arkëtuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final[1]	2015 Realizimi	2014 Realizimi	2013 Realizimi
Burimet e Fondeve:	**45,265,721**	**40,842,213**	**39,658,385**	**39,511,052**	**32,351,160**
Granti i Qeverisë -Buxheti	45,262,721	40,832,213	39,658,385	39,511,052	32,351,160
Donacionet e brendshme	-	10,000	-	-	-

[1] Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

Buxheti final ishte reduktuar për 4,423,508€ në raport më buxhetin fillestar. Reduktimi ishte bërë më rishikimin buxhetor por edhe me vendimet e Qeverisë.

Në vitin 2015, MFSK ka përdorur 97% të buxhet final ose 39,658,385€, realizim pothuajse i ngjashëm me vitin 2014, i cili ishte 98%. Megjithatë, lidhur me realizimin e buxhetit jepen shpjegimet në tabelën në vijim.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Realizimi	2014 Realizimi	2013 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	**45,265,721**	**40,842,213**	**39,658,385**	**39,511,052**	**32,351,160**
Pagat dhe Mëditjet	21,898,989	19,792,590	19,791,897	17,308,548	14,548,070
Mallrat dhe Shërbimet	8,963,805	9,490,546	8,332,969	9,419,564	8,115,830
Shërbimet komunale	803,015	834,041	812,100	819,569	784,569
Investimet Kapitale	13,599,912	10,725,036	10,721,419	11,963,371	8,902,691

Shpjegimet rreth lëvizjeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Në kategorinë e pagave dhe mëditjeve, me vendimin e Qeverisë Nr.12/64, buxheti ishte reduktuar për 2,106,399€. Ky ndryshim ishte si rrjedhojë e mos kompletimit të stafit në raport me numrin e aprovuar[2];
- Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 526,741€. Fillimisht, MFSK kishte pranuar një donacion (Ndihmë për Shkollimin e Pjesëtarëve të FSK-së) nga një ish i burgosur politik në vlerë 10,000€. Më pas, MF kishte aprovuar kërkesën e MFSK-së për transferimin e buxhetit nga kategoria e investimeve kapitale në atë të mallrave dhe shërbimeve në vlerë 729,500€. Ndërsa në fund të vitit më vendimin e Qeverisë Nr. 09/65 ishte shkurtuar buxheti në këtë kategori për 212,759€;
- Te shërbimet komunale buxheti final ishte rritur për 31,026€. Fillimisht ishte aprovuar kërkesa e MFSK-së për të transferuar buxhetin prej 50,000€ nga kategoria e investimeve kapitale në atë të shërbimeve komunale. Ndërsa më pas me vendimin e Qeverise Nr. 09/65 ishte shkurtuar buxheti për 18,974€; dhe
- Buxheti final për investime kapitale ishte reduktuar për 2,874,876€. Reduktimi prej 195,000€ (një projekt kapital) ishte bërë me rishikim të buxhetit. Më pas në kategoritë mallra dhe shërbime si dhe komunali ishin transferuar 779,500€. Ndërsa në fund të vitit me vendimin e Qeverisë Nr. 05/67 ishte shkurtuar buxheti edhe për 1,900,376€ që mbulonte disa projekte kapitale.

[2] Me ligjin për buxhet numri i aprovuar i stafit ishte 3,324 ndërsa ai aktual në dhjetor ishte 3,250.

Çështja 2 – Realizimi i buxhetit – Prioriteti i lartë

E gjetura

MFSK nuk kishte arritur të shfrytëzoj buxhetin për investime kapitale në pajtim me planin kohor të rrjedhës së parasë. Buxheti final për investime kapitale ishte realizuar 100%. Megjithatë nëse i shohim lëvizjet e buxhetit në këtë kategori në mes të buxhetit fillestar dhe atij final, shohim se kjo kategori nuk ishte menaxhuar sipas Programit për Investime Publike (PIP) si dhe planit të rrjedhjes së parasë.

Si rrjedhojë e mos shpenzimit të buxhetit, kjo kategori ishte reduktuar për 2,874,876€. Gjithashtu dinamika e shpenzimeve nuk ishte e njëjtë në gjithë vitin. Në tremujorin e fundit ishin shpenzuar rreth 69% e shpenzimeve totale, ndërsa nga kjo vetëm në muajin dhjetor ishin shpenzuar 59%.

Shkaktarët kryesor të mosrealizimit të projekteve ishin:

- Mos aprovimi i Ligjit nga Kuvendi për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forcat e Armatosura të Kosovës;
- Vonesat në inicimin e procedurave të prokurimit; si dhe
- Anulimet e prokurimeve nga OSHP-ja.

Rreziku

Planifikimi i dobët si dhe ekzekutimi i buxhetit jo në përputhje më PIP-in dhe planin e rrjedhjes së parasë, redukton efektivitetin e planeve operacionale dhe objektivave të përcaktuara nga MFSK-ja. Fluksi i madh i shpenzimeve kapitale në fund të vitit rrezikon që pagesat t`i shmangen kontrolleve të duhura.

Rekomandimi 2

Ministri, duhet të siguroj se është bërë një vlerësim i arsyeve në lidhje me nivelin e dobët të planifikimit të buxhetit. Ai duhet të sigurojë se përgatitja e buxhetit paraprihet nga një analizë e detajuar e cila pasqyron në mënyrë të plotë informatat përfshirë shpenzimet e vitit të kaluar/ndryshimet e pritura të vitit, etj. Performanca e buxhetit duhet të monitorohet në baza mujore dhe të adresohen barrierat e identifikuara në ekzekutimin e niveleve të planifikuara të buxhetit me fokus të veçantë në projektet kapitale.

3.4 Prokurimi

Gjatë vitit 2015, MFSK ka nënshkruar 116 kontrata në vlerë 8.7 milion euro. Rregullat e prokurimit synojnë të sigurojnë se fondet publike përdoren në mënyrë transparente dhe efikase për të arritur vlerën për para. Korniza ligjore përcakton qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në menaxhimin e prokurimit. Kjo përfshin kërkesën për të ulur rrezikun e mos përfundimit të kontratave dhe të realizimit të tyre të dobët. Kjo arrihet përmes zbatimit të një regjimi të ndëshkimeve në lidhje me performancën e dobët si dhe përmes sigurisë së ekzekutimit.

Ne kemi rishikuar procesin e blerjeve përmes prokurimit për të vlerësuar nëse MFSK-ja ka zbatuar procedurat dhe i është përmbajtur dispozitave të ligjit të prokurimit publik.

Më tutje, ne kemi verifikuar nëse projektet për investime kapitale kanë qenë të përfshira në Programin për Investime Publike (PIP) dhe në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve. Gjithashtu kemi rishikuar nëse gjatë vitit ka ndodhur ndonjë ndryshim lidhur me projektet e planifikuara.

Ne kemi testuar 10 kontrata të prokurimit (procedurat deri në nënshkrimin e kontratës) në vlerë 3,318,957€, si dhe 43 pagesa për shpenzime të kategorive të ndryshme në vlerë 8,721,315€. Testet tona shpalosën parregullsitë si në vijim:

Çështja 3 – Dobësi sistematike në shpenzime – Prioritet i lartë

E gjetura

Në kontratat e nënshkruara në MFSK, saktësohet se për çdo ditë vonese të liferimit të mallit, Autoriteti Kontraktues (AK) do të aplikojë ndëshkimet prej 0,25% në ditë (max.10% e vlerës totale të porosisë). Ne vërejtëm se në dy rastet e mëposhtme MFSK kishte anashkaluar kërkesat e kontraktuara:

- Te kontrata për "Furnizim me Uniforma Standarde Kamuflazh për Nevoja të FSK-së", në faturën në vlerë 404,000€, porosia është kërkuar të liferohet 90 ditë pas lëshimit të urdhërblerjes (e bërë me datë 18.02.2015) nga autoriteti kontraktues. Me përjashtim të një artikulli të faturës në vlerë 39,000€ i cili ishte dorëzuar brenda afatit kohor, pjesa tjetër prej 365,000€ ishte pranuar me datë 26.06.2015, me vonesë prej 37 ditëve kalendarike. Vlera e ndëshkimeve sipas porosisë së vonuar do të duhej të ishte 33,763€; dhe
- Në pagesën për "Furnizim me Material Ndërtimor" në vlerë 18,708€, afati kohor për dorëzimin e furnizimeve ishte maksimum 10 ditë nga data e marrjes së urdhërblerjes. Operatori Ekonomik (OE) kishte vonuar furnizimin e mallrave për 8 ditë. Vlera e ndëshkimeve do të duhej të ishte 374€.

MFSK nuk kishte arritur të arsyetonte vonesat e shkaktuara nga OE. Edhe përkundër kësaj nuk kishte aplikuar ndëshkimet e parapara me kontratë.

Rreziku Vonesat në liferimin e mallrave kanë efekt negativ mbi realizimin e buxhetit. Mosrespektimi i ndëshkimeve të parapara me kontratë përcjellët edhe me efekte financiare sidomos te kontratat me vlera të mëdha.

Rekomandimi 3 Ministri duhet të siguroj se janë forcuar kontrollet në menaxhimin e kontratave (respektimin e afateve kohore në realizimin e tyre) përfshirë edhe realizimin e pagesave. Në të kundërtën të aplikohen të gjitha ndëshkimet në pajtueshmëri të plotë me kushtet e kontratës.

Çështja 4 – Dobësitë jo-sistematike të prokurimit – Prioritet i mesëm

E gjetura Në dosjen e tenderit "Furnizim me çizme për nevojat e FSK-së" në vlerë 9,940€, në pikën III.4 te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, ishte kërkuar dorëzimi i garancionit për mallin e dorëzuar me vlefshmëri minimale prej 12 muaj.

MFSK ka shpërblyer me kontratë OE i cili nuk kishte sjellë dëshminë për plotësimin e këtij kriteri. Komisioni i vlerësimit nuk ka qenë i vëmendshëm gjatë procesit të vlerësimit.

Rreziku Lidhja e kontratave me OE të cilët nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara të përshtatshmërisë rritë rrezikun e një procesi jo efektiv të prokurimit. Njëherit, kjo rrit rrezikun që përfituesi të ofroj shërbimet me kualitet të dobët.

Rekomandimi 4 Ministri duhet të përforcojë edhe më tej procedurat gjatë procesit të vlerësimit të ofertave dhe nënshkrimit të kontratave, që të sigurohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuara në dosje të tenderit.

3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit

3.5.1 Avancet dhe Komunalitë

Në kategorinë e shpenzimeve tjera për të cilat nuk nevojitet të zhvillohen procedura të prokurimit, ne testuam disa mostra për avanse dhe komunali. Ne nuk kemi identifikuar ndonjë çështje për ta theksuar në këtë raport.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.5.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollet kyçe në këtë proces kanë dëshmuar plotësinë dhe saktësinë e të dhënave të prezantuara në PVF-të e MFSK-së. Në këtë kategori ishin shpenzuar afro 100% të buxhetit final (ref: tabela nr.2).

Megjithatë ne identifikuam disa dobësi në menaxhimin dhe mirëmbajtjen e dosjeve të personelit. Kjo është shpalosur në vijim:

Çështja 5 – Mirëmbajtje jo e mirë e dosjeve të personelit – Prioritet i mesëm

E gjetura

Nga 25 dosjet e testuara në MFSK dhe FSK, lidhur me avancimet, rekrutimet, pensionimet, pushimet pa pagesë apo të lehonisë, ne identifikuam mangësitë si në vijim:

- Në pesë raste dosjet nuk ishin plotësuar me të gjitha dokumentet e kërkuara, mungonin disa prej dokumenteve (psh. diploma, raportet e vlerësimit të performancës, evidencat e pushimeve, përshkrimi i detyrave të vendit të punës, etj). Drejtori i Departamentit të Personelit, theksoi se ka raste kur dosjet ruhen në dy vende, në FSK (në njësitë e FSK-së) dhe në ministri, andaj mund të mos jenë të kompletuara; dhe
- Në një rast, të pushimit të lehonisë, pagesat nuk ishin në përputhje me Ligjin për shërbyes civil (70% të pagës ishte paguar dy muaj më shumë se sa kërkesat ligjore). Po ashtu vendimi për pushimin e lartcekur ishte nxjerr me vonesë.

Rekomandimi nga vitet e kaluara për ndërprerjen e punësimit me kontrata të përkohshme, ende nuk është adresuar plotësisht. Edhe më tutje janë tri raste të të punësuarve me kontrata të përkohshme.

Rreziku

Pagesat e pagave të cilat bien ndesh më legjislacionin konsiderohen të parregullta. Ndërsa, moskryerja e vlerësimit të punës për të punësuarit me kohë, mund të ketë efekt negativ në performancën e mëtutjeshme të punëtorëve. Kjo gjithashtu pamundëson identifikimin e fushave për përmirësim dhe zhvillimin e tyre në mënyrë efektive.

Rekomandimi 5

Ministri duhet të sigurojë që dosjet e personelit janë azhurnuar me kohë, si dhe vlerësimet vjetore të performancës të kryhen dhe dokumentohen për të gjithë të punësuarit rregullisht. Në këtë mënyrë, krijohet baza për të shpërblyer të punësuarit sipas meritës dhe identifikohen fushat për përmirësim, e cila mundëson hartimin e një programi për zhvillimin e mëtutjeshëm të stafit. Më tutje të siguroj se rekomandimi i dhënë në vitet paraprake lidhur me ndërprerjen e punësimeve me kontrata të përkohshme të adresohet plotësisht.

3.6 Pasuritë dhe detyrimet

3.6.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Pasuritë neto me vlerë mbi 1,000€ të MFSK-së ishin 146,323,188€.

Ne kemi testuar nëse të gjitha pasuritë e përfituara gjatë vitit 2015 janë evidentuar në regjistrat përkatës dhe harmonizimin e këtyre regjistrave me informacionet e prezantuara në PVF. Gjithashtu kemi kryer një ekzaminim fizik të pasurisë për të verifikuar ekzistencën e tyre.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.6.2 Trajtimi i borxheve

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2015 ishte 542,583€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2016. Pjesa me e madhe e tyre ndërlidheshin me mungesën e zotimit të mjeteve dhe vonesave në pranimin e faturave.

Raportimi i obligimeve ishte bërë në përputhje më rregullën financiare nr.02/2013/MF, për raportimin e obligimeve të papaguara.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinioni i auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar/do t'i raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinioni mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të implementuara	Të adresuara por jo te implementuara	Të pa adresuara
3. Rekomandimet e vitit paraprak	Ministri duhet të sigurojë se plani i veprimit përcakton qartë një afat kohor dhe stafin përgjegjës për adresimin e rekomandimeve të AP-së, me fokus fillestar në fushat e rëndësisë më të madhe. Implementimi i këtij plani duhet të rishikohet nga menaxhmenti në baza të rregullta kohore.		Është adresuar. Prej dhjetë rekomandimeve, vetëm dy nuk janë implementuar. Megjithatë menaxhmenti kishte adresuar këto çështje të cilat pritet të implementohen gjatë vitit 2016.	
4.1. Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Ministri duhet të monitorojë në mënyrë sistematike përformancën buxhetore në baza mujore dhe të identifikojë dhe adresojë barrierat për të arritur nivelet e planifikuara në ekzekutimin e buxhetit, me theks të veçantë për investimet kapitale.			Nuk është adresuar ende. MFSK nuk kishte arritur të shfrytëzojë buxhetin për investime kapitale në pajtim me planin kohor të rrjedhës së parasë.
	Ministri duhet të shtojë masat e kontrollit mbi njësitë e planifikimit, në mënyrë që gjatë hartimit të buxhetit për projekte kapitale të bëhet një analizë më detaje e çmimeve të tregut. Bazuar në këtë planifikimi mund të jetë më i përafërt me realizimin e kontratave.	Po		

4.2.1. Prokurimi	Ministri duhet të siguroj kontrolle shtesë për të mundësuar që të gjitha proceset rreth vlerësimit të tenderëve të realizohen brenda afateve të përcaktuara ligjore. Ky do të jetë një faktor shtesë i cili do të ndihmon që realizimi i buxhetit të bëhet sipas planit të rrjedhjes së parasë.	Po		
	Ministri në bashkëpunim me zyrtarët përgjegjës duhet të përforcoj proceset dhe kontrollet që ndërlidhen me menaxhimin e projekteve. Në këtë mënyrë do të krijohen parakushtet për të respektuar të gjitha kërkesat e Legjislacionit në fuqi.	Po		
	Ministri duhet të shtojë kontrollet mbi proceset e prokurimit, e në veçanti në inicimin e procedurave të prokurimit nga njësitë kërkuese, të cilat duhet të bëhen në periudha më të hershme. Vlerësimi i drejtë i mundësive dhe pengesave që mund të dalin gjatë realizimit të procedurave të prokurimit do të mund të rrisin efikasitetin dhe përmbushjen e planifikimit.	Po		
4.2.2. Shpenzimet jo përmes prokurimit	Ministri duhet të siguroj se kontrollet lidhur me menaxhimin e avanceve janë duke u monitoruar në vazhdimësi. Të gjithë personat që shfrytëzojnë avanse, të bëjnë barazimet e duhura brenda periudhës së kërkuar ligjore.	Po		

4.2.3. Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Ministri duhet të rishikoj arsyet për mos adresimin e rekomandimeve të AP-së dhe të përcaktoj masa shtesë për të ndërprerë praktikat e lidhjes së këtyre kontratave në këtë formë.			Nuk është adresuar, edhe këtë vit janë tri kontrata të përkohshme.
4.3.1. Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Ministri duhet të siguroj se Komisioni i inventarizimit të pasurisë, për çdo vit bënë regjistrim fizik të pasurisë, i cili më pas duhet të harmonizohet plotësisht me regjistrat e pasurisë. Ky regjistër duhet të bëhet brenda afateve të përcaktuara ligjore, si dhe duhet t'i paraprijnë përgatitjes së PVF-ve dhe shpalosjes së tyre.	Po		
4.3.2. Trajtimi i borxheve	Ministri duhet që të ndërmerr masa të nevojshme për të identifikuar shkaqet e mos raportimit të drejtë të obligimeve të papaguara, dhe të sigurojë se vlera e saktë e obligimeve përcjellët nga muaji në muajin vijues në pajtueshmëri me kërkesat ligjore.	Po		